



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

**DOKUMENTAT E KONCENSIONIT PËR REHABILITIMIN
DHE VËNIEN NË PUNË TË TERMOCENTRALIT TË VLORË-S
SI DHE TË NDERTIMIT TË TUBACIONIT FIER-VLORË TË
FURNIZIMIT ME GAZ TË TEC-IT, TË FORMËS R.O.O.T.**

NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni I. Autoriteti Kontraktues

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit Kontraktues

Emri Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Adresa Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tirana*
Tel/Faks +355 4 22222245
Adresa e internetit www.infrastruktura.gov.al

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës

Emri Etleva Kondi
Adresa Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Posta elektronike etleva.kondi@infrastruktura.gov.al

I.3 Lloji i autoritetit kontraktues dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore

Institucion qendror	Institucion i pavarur
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësitë e qeverisjes lokale	Të tjera
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni II. Objekti i kontratës

II.1 Lloji i kontratës

Punë	Shërbime
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

II.2 Përshkrim i shkurtër i koncensionit/kontratës së partneritetit privat-publik

- Objekti i kontratës: Rehabilitimi dhe Vënia në Punë e Termocentralit të Vlorë-s si dhe të ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë të furnizimit me gaz të tij
- Lloji i kontratës: **R.O.O.T (Rehabilitate – Own – Operate – Transfer)**
- Burimi i financimit: **Kompani private tregtare / Kapital privat**
- Vlera e parashikuar e projektit sipas studimit të fizibilitetit është 58,719,958 Euro.

II.3 Vendndodhja e objektit të kontratës

Termocentrali i Vlorës (TEC) ndodhet në bregun e detit Adriatik, 6 km nga qyteti i Vlorës (Shqipëri). Vendndodhja e termocentrali mund të shihet në figurën e mëposhtme:



Koordinatat e vendndodhjes së TEC janë:



Pozicioni ne terren i Tec Vlore

Vendndodhja e sheshit te TEC Vlore shtrihet sipas koordinatave te mëposhtme të cilat janë projektuar sipas sistemit koordinativ kombëtar KRGJSH.

Nr pikave	Koordinata X	Koordinata Y
1	451990.499	4484132.830
2	452104.270	4484273.060
3	452171.739	4484228.080
4	452225.979	4484300.841
5	452343.719	4484193.684
6	452236.562	4484052.132
7	452296.094	4484008.476
8	452235.239	4483937.038

Seksioni III. Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

III.1 Kriteret e kualifikimit sipas shtojcës nr. 9

III.2 Sigurimi i Ofertës

Kur një Operator Ekonomik merr pjesë në një procedure koncesioni/partneriteti publik privat, atëherë atij i kërkohet të japë një Sigurim Oferte së bashku me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjenden në Shtojcën 3.

Seksioni IV. Procedura

IV.1 Lloji i procedurës

E hapur	E kufizuar	Me negociatë, me njoftim paraprak
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Pasi ofertuesit të përmbushin kriteret e lartpërmendura, ata do të vlerësohen dhe gjykoen sipas kriterëve të mëposhtme vlerësuese me rëndësinë përkatëse sikundër tregohet.

		Kriteret e Vlerësimit	Pikët maksimale	
1		Kriteri teknik	40	
	1.1	<ul style="list-style-type: none">Plani operacional për riparimin, shndërrimin, kthimin funksional të Tec-it		10
	1.2	<ul style="list-style-type: none">Plani operacional në lidhje me ndërtimin e tubacionit gazsjellës		10
	1.3	<ul style="list-style-type: none">Tarifa e koncensionit (min. 2% e energjisë vjetore elektrike të prodhuar)		5
	1.4	<ul style="list-style-type: none">Vlerësimi i ndikimit social dhe mjedisor		15
2		Kriteret financiare	30	
	2.1	<ul style="list-style-type: none">Kostot e parashikuara të investimit për rivënien në funksion të TEC-it të Vlorës		20
	2.2	<ul style="list-style-type: none">Kapitali i vet (equity)		5
	2.3	<ul style="list-style-type: none">Xhiro vjetore e vitit te fundit ushtrimor		5
3		Përvoja e ofertuesit ne 7 vitet e fundit	23	
	3.1	<ul style="list-style-type: none">Përvoja në ndërtimin e impianteve për prodhimin e energjisë me gaz		8

	3.2	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në ndërtimin e impianteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera 		3
	3.3	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në tregtimin e energjisë elektrike 		3
	3.4	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në operimin dhe/ose mirëmbajtjen e impianteve energjetike me turbinë gazi me cikël të kombinuar 		6
	3.5	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në tregtimin/shpërndarjen e gazit 		3
4		Koha për vënien ne funksion te TEC	7	
	4.1	<ul style="list-style-type: none"> Koha për rikonstruksionin e TEC 		5
	4.2	<ul style="list-style-type: none"> Koha për ndërtimin e tubacionit të gazit 		2
			Gjithsej	100

IV.3 Afati kohor për dhënien e ofertave

Brenda dhe jo më vonë se: Data: **28/02/2019 Ora: 12:00.**

Oferta duhet dhënë nëpërmjet rrugës elektronike. Operatorët ekonomikë duhet ta japin ofertën në mënyrë elektronike në faqen e internetit të APP: www.app.gov.al

IV.4 Kufizimi kohor për ofertat e hapura

Brenda dhe jo më vonë se: Data: **28/02/2019 Ora: 12:00.**

Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet rrugës elektronike.

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes zyrtare të ofertave, që dërgohen me mënyrë elektronike, do t'u komunikohet të gjithë operatorëve ekonomikë të cilët kanë paraqitur oferta, bazuar në kërkesat e tyre.

IV.5 Koha e vlefshmërisë së ofertave

150 ditë

IV.6 Gjuha/gjuhët e hartimit të ofertave ose e kërkesave për pjesëmarrje

Shqip Anglisht
Tjetër gjuhë _____

Seksioni V. Informacione të mëtejshme

V.1 Dokumente sipas tarifës

Po Jo

Nëse po

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DK/PPP te Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë kanë të drejtë të kontrollojnë DK/PPP para se ato të blihen. Vlera e tarifës që do të paguhet nga operatori ekonomik në rastin e një ankese para KPP, është 10% e vlerës së Sigurimit të Ofertës.

V.2 Informacion shtesë

MIE do të organizojë një vizitë në terren me date 15 Janar 2019 në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të marrin informacionin e nevojshëm lidhur me vendndodhjen e TEC-it. Pjesëmarrësit në këtë vizitë do të takohen në ora 12:00 në vendndodhje. Adresa e TEC-it është: Rruga e Pishave, Vlorë 9400. Personi i kontaktit dhe përgjegjës do të jetë znj. Etleva Kondi, me adresë të postës elektronike: etleva.kondi@infrastruktura.gov.al. Pjesëmarrja në këtë vizitë është e detyrueshme. Pas vizitës në terren, kompanitë që kanë marrë pjesë në vizitën e detyrueshme në të, do të marrin akses për në dhomën e të dhënave elektronike. Aksesit do t'i jepet çdo ofertuesi të mundshëm njëkohësisht.

Shënim: AK sipas miratimit të masterplanit të gazit në të cilin përfshihet edhe Gazsjellësi nga Pika e daljes së Gazsjellësit TAP në Seman (Fier) në drejtim të TEC-it Vlorë, informon se MIE është shpallur fitues i financimit nga WBIF të hartimit të projektit të zbatimit të këtij gazsjellësi. Ndodhur në këto kushte AK rezervon të drejtën të vërë në dispozicion të fituesit projektin në fjalë.

Gjithashtu AK rezervon të drejtën që tubacioni i gazsjellësit pas ndërtimit të jetë subjekt i trajtimit/pronësisë/mirëmbajtjes, nga/te Albغاز sh.a., sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Përmbajtja e parashikuar e dhomës së të dhënave të TEC-it të Vlorës (jo shteruese)

1. Turbina e gazit të rrëshqitshëm (Skid Gas Turbine)

- Skema energjetike
 - Sistemi lëndë djegëse Gaz (Fuel Gas System) – Korrigjimi i difektit/gabimit
 - Sistemi lëndë djegëse Gaz P&ID
 - Linja e nxehjes së tubacionit lëndë djegëse të gazit (Fuel Gas Pipe heating line)
 - Trubina e gazit
 - Filter për gaz natyror
- Instruksionet Operimit dhe Mirëmbajtjes O&M
 - Valvulat koaksiale
 - Valvula e kontrollit të gazit DN125 /PN40
 - Valvula e ndalimit të gazit në rast urgjence DN125/PN40
 - Valvula e kontrollit të gazit pilot DN65/PN40
 - Startimi GT – Sekuenca e lëndës djegëse të gazit (guidë e përgjithshme për operimin)
 - Startimi GT – Sekuenca Master (guidë e përgjithshme për operimin)
 - Manual udhëzues i SITRANS (transmetues për presionin)
 - Karakteristikat teknike, përshkrimi i mirëmbajtjes së Njësisë Termometrike
 - Manuali i trajnimit "Sistemi i lëndës djegëse të gazit"
- Vizatime
 - Përmyllja e skidit të gazit (Skid Gas Enclosure) – Arranxhimi i përgjithshëm
 - Turbina e gazit P&ID sistemi i lëndës djegëse të gazit

- Turbine e avullit, gjenerator, seti i turbinës së gazit – plani i arranzhimit të përgjithshëm
- Valvula Vimec & përshkrimi i komponentëve

2. Operimi dhe Mirëmbajtja Offshore

- Tuba nënujorë dhe vozat mbi-ujore të ngarkimit– manuali Operimit & Mirëmbajtjes
- Sistemet offshore systems – Manuali operimit dhe mirëmbajtjes
- Water Intake water outfall fuel oil plem – libri i çertifikimit
- Tubacioni i lëndës djegëse të naftës – libri i çertifikimit
- Tubat GRP – libri i çertifikimit
- Valvula Plem – manuali Operimit dhe mirëmbajtjes
- Sistemet Offshore – programi i mirëmbajtjes
- Sarplast
 - Dokumenti i shitësit – instalimi i xhuntos Bell Spigot (Bell Spigot Joint)
 - Dokumenti i shitësit – Depozim, trajtim, paketim, transport me anije, inspektim dhe specifikim i riparimit
 - Dokumenti i shitësit – vizatimi i komponentit të tubëzimit GRP (GRP piping component drawing)
- Mekanizmat e sigurimit të rrjedhjes së gazit (Pig Traps)
 - Lançimi dhe marrja e Pig Traps – raporti i përlllogaritjes
 - Lançimi dhe marrja e Pig Traps – libri i çertifikimit
 - Lançimi dhe marrja e Pig Traps – libri teknik
 - Dizenjo e ndërtimit
 - Regjistri i kualifikimit të procedurës QW -483: Proçesi i saldimit GTAW + FCAW
 - Regjistri i kualifikimit të procedurës QW -483: Proçesi i saldimit SAW + FCAW
 - Regjistri i kualifikimit të procedurës QW -483: Proçesi i saldimit GTAW + SMAW
 - WPS (Specifikimi i Proçedurës së Saldimit)
 - Kualifikimi i performancës së salduesit: QW-484A
 - Libri i saldimit: EPC i një centrali elektrik me cikël të kombinuar në Vlorë
 - Specifikimi i procedurës së saldimit: FCAW + SAW
 - Specifikimi i procedurës së saldimit: FCAW + GTAW
 - Specifikimi i procedurës së saldimit: SMAW+ GTAW
 - Specifikimi i procedurës së saldimit: FCAW
 - Çertifikata e operimit
 - Raportimi i testimit jo-shkatërrues (NDT Report) – testimi magnetik i grimcave
 - Raportimi i testimit jo-shkatërrues (NDT Report) – testimi radiografik
 - Çertifikata e kualifikimit të operatorit të testimit jo-shkatërrues
 - Proçedura
 - Proçedura për ekzaminimin e grimcave magnetike (standardi europian) (en standard)
 - Proçedura e ekzaminimit radiografik
 - Proçedura e lyerjes së përgjithshme

- Raporti i ushtrimit të dhimbjes Pain application report
- Çertifikata e materialeve
 - Çertifikata e testimit të mullirit (Mill test certificate)
 - Analiza kimike
 - Çertifikata e cilësisë së produktit dhe materialit
- Çertifikimi
 - Çertifikimi i hidrotetit
 - Çertifikimi i kalibrimit të instrumentit dytësor

3. Ruajtja afatgjatë e operimit dhe mirëmbajtjes

- Mënyra e konservimit afatgjatë të faciliteteve të centralit offshore (Offshore Plant Facilities Long Term Conservation Mode)
- Proçedura e ruajtjes për ndërpreje afatgjata të CCPP (CCPP Preservation procedure for CCPP long-term outage)

4. Operimi dhe mirëmbajtja e centralit, manuali i operimit dhe mirëmbajtjes

- Seksioni A – E përgjithshme
- Seksioni B – Manuali i operimit të centralit
 - Vizatime
 - Voltazhi i lartë dhe i mesëm: diagrama me një vijë
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të avullit kryesor të presionit të lartë (P&ID main steam HP)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të avullit kryesor të presionit të mesëm (P&ID main steam IP)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të avullit kryesor JP
 - Simbiologjia e diagramës së tubëzimit dhe instrumentimit (P&ID Symbiology)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të kondensimit (P&ID Condensate system)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të interkoneksioneve të kondensatorit
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të furnizimit me naftë si lëndë djegëse (P&ID fuel oil supply)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të depozitimit dhe shpërndarjes të ujit të shërbimit (P&ID service water storage and distribution)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të depozitimit dhe shpërndarjes së ujit të demineralizuar
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të vakumit
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të shpërndarjes së injeksionit kimik
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të depozitimit dhe shpërndarjes së nitrogjenit
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të çarjeve (vents) dhe shkarkuesve ST dhe GT
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të mostrave
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit HVAC

- Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të kanalizimit të pastër (P&ID clean drain system)
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të kanalizimit të mbetjeve
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të komponentëve të ftohjes së ujit
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të ujit të ftohjes kryesore
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit të sistemit të ajrit të kompresuar
- Përshkrimi funksional
 - Sistemi i avullit kryesor
 - Sistemi kondensimit
 - Sistemi qendror i ftohjes së ujit
 - Sistemi i lëndës djegëse të naftës (Fuel oil system)
 - Sistemi i ftohjes së përbërësve
 - Sistemi i shpërndarjes së ujit të shërbimit (Service water distribution system)
 - Sistemi i shpërndarjes së gjysmë-ujit (Semi water distribution system)
 - Sistemi i kullimit të ujit
 - Sistemi i kullimit të pastër
 - Sistemi i ajrit të kompresuar
 - Sistemi i vakumit
- Balanca e nxehtësisë dhe masës së centralit elektrik me cikël të kombinuar
- Lista e lëngjeve (Fluid list)
- Lista e pajisjeve
- Lista e linjave (Line list)
- Lista e instrumenteve
- Specifikimi i tubëzimit
- Lista e valvulave
- Seksioni C – Siguria
 - Vizatimi
 - Njësia qendrore e thithjes së ujit për zjarr (Firewater pumping central unit)
 - Sistemi i përmytjes (Deluge system)
 - Sistemet e shkumës (Foam systems)
 - Hidrantët e brendshëm dhe fikësit e zjarrit
 - Sistemi i shkumës dhe ftohjes
 - Instruksione për raste emergjence dhe evakuimi
 - Planet e evakuimit – linjat udhërrëfyese
- Seksioni D – manuali i shërbimit dhe mirëmbajtjes
- Shërbimi E – Ansaldo GT
 - Manuali i radhitjes GT (GT Assembly manual)
 - Manuali i komisionimit GT (commissioning manual)
 - Manuali i trajnimit GT
 - Manuali GT i operimit dhe mirëmbajtjes
 - Sistemi i gazit propan – Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes
 - Manuali GT dhe ST i instruksioneve të sistemit të kontrollit
 - Manuali FF i operimit dhe mirëmbajtjes
 - Libri i çertifikimit të pajisjeve të sistemit GT FF

- Manuali i instruksioneve dhe mirëmbajtjes së radhitjes GT (Assembly instructions & maintenance manual)
- Bordet e nënshpërndarjes GT (Sub distribution boards) – guidat e përdoruesve dhe manuali i mirëmbajtjes
- Dosja finale e çertifikimit GT
- Manualet e pjesëve të shitësit të jashtëm (Outside vendor parts handbooks)
- Kurbat GT të start-up-eve
- Shërbimi E – Nooter HRSG
 - Libri me të dhënat finale
 - Manuali HRSG i komisionimit
 - Manuali i ngritjes mekanike (Mechanical erection manual)
 - Vëllimet HRSG të operimit dhe mirëmbajtjes
- Shërbimi E – Ansaldo ST
 - Manuali komisionimit
 - Vëllimet e operimit dhe mirëmbajtjes
 - Dosja me çertifikimin final
 - Çertifikimi i pajisjeve të sistemit FF
 - Instruksionet e radhitjes dhe operimi e mirëmbajtja e mbylljes (Assembly instructions and O&M of enclosure)
 - Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes – valvualet DN50 që përdoren me dorë
 - Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes – valvulat e përdorura me dorë
 - Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes – pompat e sistemit të purifikimit të naftës (oil purification system pumps)
- Shërbimi E – Ansaldo GEN
 - Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes
 - Generator excitation board – manuali i udhëzimit
 - Generator excitation voltage transformer – manuali i udhëzimit
 - Bordi i konvertuesit të frekuencës statike
 - Transformatori i voltazhit SFC
 - Kubikët e tokëzimit neutral (Neutral grounding cubicle) – manuali i instalimit dhe mirëmbajtjes
 - Sistemi i mbrojtjes
 - Dosja e çertifikimit final
- Shërbimi E – OFMECO COND
 - Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes së kondensatorit të avullit sipërfaqësor
 - Libri i garancisë së cilësisë së kondensatorit të avullit sipërfaqësor
- Shërbimi E – Uji dhe Avulli
 - Pompat e kondensimit të ekstraktimit – manuali i operimit dhe mirëmbajtjes
 - Cikli i avullit të ujit
 - Sistemi i avullit të ujit
 - Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes të valvulave P91
- Shërbimi E – Balancimi i centralit
- Shërbimi E – Voltazhi i lartë elektrik
 - Dokumentet referuese, përfshi vizatimet
 - Pajisjet e voltazhit të lartë
 - Tensioni i lartë dhe i mesëm
 - Doko – raportet e manifakturimit
- Shërbimi E – Tensioni i mesëm – i lartë elektrik (MV-LV)

- Dokumentet referuese, përfshi vizatimet
- Tubi/kanali i izoluar i konduktorit paralel (Isolated bus duct)
- Transformuesi Set-up
- Thyesi i qarkut të gjeneratorit (Generator circuit breaker)
- Sistemi DC & UPS – faqja me të dhëna
- Shërbimi E – Siemens DCS
- Shërbimi E – furnizimi me instrument – manuallet e operimit dhe mirëmbajtjes
- Shërbimi E – Komunikimi dhe siguria

5. I ndërtuar (As built)

- Civil
 - Plani evakuimit
 - Të përgjithshme
 - Admin
 - Workshop
 - Gropa e digës (Weir pit)
 - Marrja e ujit të detit, klorinimi
 - Stiva e tubit (Pipe rack)
 - Kontrolli
 - Trafo
 - Demi
 - Zona e serbatorit (Serbatoi area)
 - Holli turbinës
 - Zona HRSG
 - Babica
- Mekanike
 - Dokumentet transmetuese
 - Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit siç është ndërtuar
- Proçesi
 - DSP gjysmë-ujë
 - DSP ujë shërbimi
 - DSP ujë mbetje
 - DSP sistemi i avullit
 - DSP sistemi kondensimit
 - DSP kanalizimit të pastër
 - DSP sistemit të vakumit
 - DSP naftës si lëndë djegëse
 - DSP sistemi i ftohjes së ujit
 - DSP ftohjes së komponentit
 - DSP ajri i kompresuar
 - CCPP përshkrimi i performancës monitoruese specifikimet e tubëzimit (monitoring description Piping specification)
- Lufta kundër zjarrit
- I&C
- Sistemet ndihmëse
- Elektrike
- Offshore

6. Diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit (P&ID)

- Tharësit e ajrit të kompresuar
- DSP ajri i kompresuar
- BOP
- Doza kimike (Chemical dosing)
- Njësia e klorinimit
- Pompat e ekstraktimit të kondensuar (Condensate extraction pumps)
- Kondensator
- Shvajëzimi (De-oiling)
- Desalin Demin
- Gjenerator dizel në rast emergjence
- Lufta kundër zjarrit dhe diagrama e tubëzimit dhe instrumentimit
- Ngrohësi i naftës (Fuel oil heater)
- Stacioni matës i lëndës djegëse të naftës
- Trajtimi i lëndës djegëse të naftës
- HRSG
- Pompat HRSG të ushqimit të ujit (feedwater pumps)
- Fabrikë me ujë të nxehtë të ftohur HVAC (Hot chilled water plant)
- Sistemi i shndërrimit të ujit në ujë të pijshëm (Potabilization sys)
- Furnizimi me ujë të pijshëm (Portable water supply)
- Propan
- Sistemi i mostrës
- Marrja e ujit të detit (Sea water intake)
- TG
- TV
- Pompat e vakumit

Seksioni VI. Lloji i kontratës: ROOT (Rehabilitate- Own- Operate- Transfer)

Ofertuesi do të përgatisë ofertën bazuar në modelin ROOT;

HYRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur të implementojë projektin e rehabilitimit dhe të operimit të Termocentralit të Vlorës, përfshirë mundësisht një degëzim të tubacionit të gazit Fier-Vlorë. Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet bazuar në një procedurë të hapur konkurrimi, sipas kriterëve specifike të kualifikimit dhe vlerësimit që ndodhen në këtë dokument. Kohëzgjatja e kontratës konçesionare/PPP është 20 vjet, duke filluar nga momenti i rehabilitimit, operimit të TEC-it dhe pasi të jetë siguruar furnizimi me gaz i TEC-it të Vlorës.

1.1. Informacion i mëtejshëm dhe vështrim i përgjithshëm

a. Pozita gjeografike

TEC-i i Vlorës ndodhet në bregdetin Adriatik, 6 km nga qyteti i Vlorës (Shqipëri). Vendndodhja e centralit mund të shihet në figurën e mëposhtme:



Figura 1: Hartë e rajonit të Vlorës

Koordinatat e TEC-it Vlore janë si më poshtë:



Pozicioni ne terren i Tec Vlore

Vendodhja e sheshit të TEC Vlorë shtrihet sipas koordinatave të mëposhtme të cilat janë projektuar sipas sistemit koordinativ kombëtar KRGJSH.

Nr pikave	Koordinata X	Koordinata Y
1	451990.499	4484132.830
2	452104.270	4484273.060
3	452171.739	4484228.080
4	452225.979	4484300.841
5	452343.719	4484193.684
6	452236.562	4484052.132
7	452296.094	4484008.476
8	452235.239	4483937.038

b. Përshkrimi i kushteve lokale

Centrali Elektrik me Cikël të Kombinuar (CCPP) Vlorë është një central me fuqi 97 MW që operohet nga KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a.). Prodhimi i energjisë aktualisht bazohet në një central me një njësi me cikël të kombinuar që përbëhet nga një turbinë avulli që prodhon energji elektrike. Kondesatori i ciklit të avullit ftohet me ujë deti. Që prej Janarit 2012 centrali elektrik nuk ka funksionuar.

Pas komisionimit të centralit elektrik dy ngjarje të paparashikuara ndodhën në sistemin e ftohjes që shkaktuan mbylljen e të gjithë fabrikës si dhe nevojën për riparime në pjesë të sistemit të ftohjes.

Incidenti i parë ndodhi në 2009, disa muaj pas komisionimit të fabrikës. U gjet se një difekt në tubacionet e marrjes dhe të shkarkimit të ujit ftohës në det shkaktoi hyrjen e sedimentit në tubacion çka shkaktoi prishjen e sistemit.

Pas një operimi pa difekt, një tjetër incident i dytë ndodhi në Janar 2012 dhe shkaktoi një tjetër prishje të shkarkimit aktual të impjantit. Gjatë një stuhie, një pjesë prej më shumë se 200 metra e tubacionit të marrjes së ujit u ngrit jashtë shtratit të tij. Kjo shkaktoi çarjen, bllokimin dhe lëvizjen në një pozicion të papërshtatshëm. Për këtë shkak, sistemi i ftohjes doli jashtë përdorimit.

Përgjithësisht, sistemi ftohës përbëhet nga pajisje mekanike të vendndodhja e TEC-it (si pompa uji, baseni i ujit të detit dhe kondesatori i avullit), si dhe nga një sistem tubash që sjellin ujin e detit në TEC (hyrja) dhe që e dërgon sërish në det (nxjerrja).

Linjat e marrjes dhe nxjerrjes së ujit të detit ndodhen në zonë të cekët nënlitorale të gjirit të Vlorës. Tubat janë vendosur paralel me murin mbrojtës në anën veriore, jashtë Portit Triporti të Vlorës. Përgjatë gjatësisë së tubave të marrjes dhe nxjerrjes, pjerrësia ka një kënd të ulët dhe konsistent (lartësi në gjatësi (height in length ~ 1 in 150). Thellësia e ujit të tubacionit drejt detit arrin në 5.5 m në difuzorin e daljes (~650 m nga bregu) dhe 6.25 m në kërpuhën e hyrjes (~1000 m nga bregu).

Përveç furnizimit me ujë të ftohtë, duhen bërë ndryshime edhe që të përdoret gazi si burim energjie, në vend të naftës. Këto ndryshime janë minimale dhe përcaktohen nga oferta. Termocentrali i Vlorës (TEC) aktualisht përdor naftë që të prodhohë energji elektrike. Në vend të naftës, planifikohet të përdoret gaz natyror si lëndë djegëse për Centralin Elektrik të Vlorës.

Për këtë arsye, duhet ndërtuar një degëzim tubacioni rreth 40 km i gjatë për të lidhur termocentralin e Vlorës me Tubacionin Trans-Adriatik (TAP). Pika e lidhjes me TAP-in ndodhet pranë qytetit dhe rajonit të Fierit, sipas masterplanit bashkëlidhur këtyre dokumentave.

Ofertuesit duhet të japin një ide të qartë dhe të saktë se si projekti i tubacionit mund të realizohet.

1.2. Këto udhëzime (“Udhëzime për Ofertuesit”) si dhe “Ftesa për Ofertë” u adresohen të gjithë subjekteve ligjore ose konsorciumeve të tyre, të cilët synojnë të marrin pjesë në procedurën konkurruese të përzgjedhjes.

1.3. Bazuar në artikullin 43, pika 4 e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Mbi prokurimet publike” të amenduara, MIE do të organizojë një vizitë në terren me date 15 Janar 2019, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të marrin informacionin e nevojshëm lidhur me vendndodhjen e TEC-it. Pjesëmarrësit në këtë vizitë do të takohen në orën 12:00 në TEC Vlorë me adresë: Rruga Pishave, Vlorë 9400. Më pas do të vijohet me vizitën në stacionin e gazit në Seman Fier. Personi i kontaktit dhe përgjegjës do të jetë znj. Etleva Kondi dhe z. Ervin Duraj, me adresë të postës elektronike: etleva.kondi@infrastruktura.gov.al ervin.duraj@infrastruktura.gov.al. Pjesëmarrja në këtë vizitë është e detyrueshme. Më pas pjesëmarrësve do t’u jepet akses në dhomën e të dhënave. Në fund të vizitës në terren, pjesëmarrësive do t’u jepet një certifikatë pjesëmarrjeje. Të gjitha shpenzimet e vizitës do të mbulohen nga vetë ofertuesi (operatorët ekonomikë) dhe nuk janë të rimbursueshme.

1.4. Shpenzimet: Ofertuesi Fitues do të mbulojë shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dërgimin e ofertës, shpenzimet e publikimit në gazeta ndërkombëtare, të cilat do të të njoftohen në “Aplikimi Njoftues i Fituesit”, si dhe shpenzimet të tjera që parashikohen në këto dokumente dhe në përputhje me ligjin nr 125/2013 “Mbi konçesionet dhe partneritetin publik-privat” të ndryshuar.

1.5. Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën ta ndërpresë krejtësisht këtë procedurë konkurruese të përzgjedhjes pa dhënë arsytet dhe pa ndonjë detyrim financiar ndaj konkurrentëve. Ofertuesi nuk gëzon të drejta të pretendojë kompensim për kostot dhe humbjet.

2. DOKUMENTET E PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

2.1. Përmbajtja

2.1.1. Lloji i projektit dhe kërkesat teknike, procedura e konkurrimit, kushtet e kontratës dhe kërkesat ligjore dhe ekonomiko-financiare përcaktohen në dokumentet e procedurës së konkurrimit, që përmbajnë:

- Shtojca 1: Formulari për ofertë (Bid form)
- Shtojca 2: Ftesën për ofertë
- Shtojca 3: Formulari i sigurimit të ofertës
- Shtojca 4: Lista e informacionit konfidencial
- Shtojca 5: Deklarata e përmbushjes së kërkesave të dokumenteve standard të konçesionit/partneritetit publik-privat
- Shtojca 6: Deklarata e konfliktit të interesit
- Shtojca 7: Formulari i vlerësimit
- Shtojca 8: Mbi zotërimin e makinerive
- Shtojca 9: Kriteret e kualifikimit
- Shtojca 10: Deklarata e dëshmisë së penaltetit
- Shtojca 11: Kriteret e vlerësimit
- Shtojca 12: Vetë-deklarimi për ofertues me kombësi të huaj
- Shtojca 13 (nuk aplikohet): Implementimi i projektit dhe specifikimet teknike

- Shtojca 14: Vlerësimi i kostove të punës
Shtojca 15: Njoftim standard për ofertuesin e skualifikuar
Shtojca 16: Formulari i njoftimit për fituesin
Shtojca 17: Kushtet e përgjithshme të kontratës
Shtojca 18: Kushte të veçanta
Shtojca 19: Formulari i sigurimit të kontratës
Shtojca 20: Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar
Shtojca 21: Formulari i ankesës ndaj prokurimit që i dërgohet autoritetit kontraktues
Shtojca 22: Formulari i prokurës

2.1.2. Çdo ofertues duhet të marrë në konsideratë udhëzimet, kriteret, kushtet, specifikimet, afatet kohore dhe të gjithë informacionin në dokumentet e procedurës së konkurrimit.

Nëse ofertuesi:

- i) nuk i plotëson të gjithë dokumentacionin dhe dokumentet e procedurës; ose
- ii) dërgon një ofertë e cila nuk është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e dokumentit të procedurës së konkurrimit, ,

autoriteti kontraktues do të vendosë se oferta nuk është në përputhje me kërkesat e dokumenteve të procedurës së konkurrimit dhe do ta refuzojë ofertën.

2.2. Shpjegimet mbi dokumentet standard të procedurës së konkurimit

Të gjitha përgjigjet bashkë me shpjegimet relevante do t'u njoftohen palëve të interesuara. Ofertuesit e kësaj procedure konkurrimi kanë të drejtën të kërkojnë amendim ose korrigjim të dokumenteve standard të procedurës së konkurimit dhe duhet ta dërgojnë kërkesën nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Ky pretendim duhet plotësuar brenda 10 ditësh që nga dita pas publikimit të njoftimit të kontratës.

2.3. Ndryshime në dokumentet e procedurës së konkurimit

2.3.1. Çdo kohë, para afatit të fundit të dërgimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues duhet të shtyjë afatin kohor për pranimin e ofertave, në përputhje me ligjin kur bëhen ndryshime në dokumentet e procedurës.

2.3.2. Të gjitha ndryshimet e bëra nga Autoriteti Kontraktues do të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimeve Publike. Dokumentet e ndryshuara duhen konsideruar si dokumente të procedurës së prokurimit për këtë procedurë përzgjedhëse të konkurimit.

2.3.3. Në mënyrë që ofertuesit të kenë kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshimet përkatëse në ofertën e tyre, Autoriteti Kontraktues mund, me iniciativën e vet, ta shtyjë afatin kohor për pranimin e ofertave. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues “Mbi konçesionet dhe partneritetin publik-privat” duhet të publikojë afatin e ri kohor për dërgimin e ofertave në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimeve Publike.

3. OFERTA: PËRGATITJA

3.1. Oferta duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme

- a) Formulari i ofertës në përputhje me Shtojcën 1.
- b) Formulari i Sigurimit të Ofertës të plotësuar në përputhje me modelin e bashkëngjitur Shtojca 1.
- c) Dokumentet lidhur me konçesionin në përputhje me kërkesat e parashtruara në Shtojcën 9.

Një operator ekonomik duhet të dërgojë vetëm një ofertë.

Çdo e dhënë e rreme do të përbëjë një shkak ligjor për Autoritetin Kontraktues që ta skualifikojë ofertuesin në çdo kohë. Nëse një gjë e tillë zbulohet ose bëhet e ditur pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën ta përfundojë marrëdhënien e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe të marrë një kompensim për humbjet aktuale të shkaktuara. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, draftimi i rremë apo falsifikimi i dokumentave si dhe çdo deklaratë apo e dhënë e cila nuk pasqyron të vërtetën, përbën vepër penale.

3.2. Sigurimi i Ofertës

3.2.1. Si pjesë e ofertës teknike, ofertuesi duhet të dërgojë Sigurimin e Ofertës në përputhje me Formularin e Sigurimit të Ofertës (të gjendur në Shtojcën 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës), në vlerë 2% të vlerës së investimit të parashikuar nga ofertuesi.

3.2.2. Sigurimi i Ofertës duhet dërguar detyrimisht në formën e një depozitë ose garancie të lëshuar nga një bankë e licensuar për këtë aktivitet. Ofertuesi do të garantojë se Sigurimi i Ofertës është i vlefshëm për një periudhë 30-ditore pas përfundimit të vlefshmërisë së ofertës, e cila është 150 ditë. Kësisoj, oferta duhet siguruar për 180 ditë që nga data e skadimit të afatit kohor për dërgimin e saj. Për arsye motivuese, Autoriteti Kontraktues

mund të kërkojë nga Ofertuesi që ta zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës në rast se rrethana të caktuara kanë impakt në zgjatjen e afatit kohor të vlerësimit të ofertës relevante ose në dërgimin e Sigurimit të Kontratës ose në ndonjë rast tjetër që ka impakt në zgjatjen e afatit të detyrueshëm kohor. Nëse periudha e vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës nuk zgjatet, atëherë Ofertuesi skualifikohet.

- 3.2.3.** Sigurimi i Ofertës duhet dërguar bashkë me ofertën para përfundimit të afatit kohor për dërgimin e ofertave. Çdo ofertë që nuk shoqërohet nga Sigurimi i Ofertës do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Sigurimi i Ofertës do të bëhet në emër të: i) kompanisë, në rast se Ofertuesi është një kompani e vetme; ose ii) në emër të kompanisë udhëheqëse nëse Ofertuesi është një Bashkim i përkohshëm kompanish.
- 3.2.4.** Me kërkesë të një Ofertuesi jo-fitues, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë Sigurimin e Ofertës sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë nga dita e përfundimit të vlefshmërisë kohore të ofertës ose pas zgjatjes së afatit kohor të tij.
- 3.2.5.** Sigurimi i Ofertës së Ofertuesit Fitues do t'i kthehet atij pas depozitimit pranë Autoritetit Kontraktues të Sigurimit të Kontratës.
- 3.2.6.** Sigurimi i ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues në rast kur Ofertuesi:
- i) e merr ofertën e tij gjatë procedurës së konkursit para skadimit të afatit kohor të vlefshmërisë së ofertës (gets his bid during the competition procedure before the bid validity time limit expires);
 - ii) nuk paraqet Sigurimin e Kontratës (nëse ai është fitues);
 - iii) nuk nënshkruan kontratën konçesionare (nëse ai është fitues) brenda afateve kohore të specifikuar në Formularin e Njoftimit të Fituesit (Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit);
 - iv) ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;
 - v) nëse ai është fitues, refuzon pagesën e shpenzimeve sipas pikës së mësipërme 1.4.

3.3. Prokura

Çdo ofertues (ose anëtar i Konsorciumit të Përkohshëm, kur ofertuesi është i tillë) do të dërgojë një prokurë noteri në formën e përcaktuar në Shtojcën 22, që tregon se personi (personat) të cilët kanë nënshkruar Ofertën, gëzojnë të drejtën për ta nënshkruar atë.

3.4. Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Ofertat do të jenë të vlefshme për 150 ditë, duke filluar që nga moment i skadimit të “afatit kohor për dërgimin e ofertave”. Një ofertë me vlefshmëri më të shkurtër kohore, se sa parashikon afati kohor, nuk do të konsiderohet e pranueshme nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

3.5. Formatit dhe nënshkrimi i ofertës

- 3.5.1.** Çdo ofertues do të përgatisë dhe do ta dërgojë ofertën në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP). Informacione të detajuara lidhur me dërgimin (upload-imin) e ofertës gjenden në manual, që gjendet i publikuar në adresën <https://www.app.gov.al>.
- 3.5.2.** Ofertuesi, i cili shpallet fitues i konkurst, do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues ofertën origjinale. Oferta origjinale do të shtypet/printohet ose shkruhet me bojë që nuk zhduket. Personi apo personat të cilët kanë të drejtën të nënshkruajnë (të autorizuar nëpërmjet prokurës së dërguar si pjesë e Ofertës Teknike, në përputhje me piken 3.3) do të nënshkruajnë Ofertën.
- i) Nënshkrimi i versionit origjinal të ofertës;

ii) Nënshkrimi i secilës faqe të versionit origjinal të dokumenteve që shoqërojnë ofertën ekonomike.

3.5.3. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa përveç se në rastin kur korrigjimet janë nënshkruar nga personi apo personat që kanë të drejtë ta nënshkruajnë ofertën. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e dërguar (upload-uar) në faqen e internetit të APP-së.

4. DËRGIMI I OFERTËS ORIGJINALE

4.1. Formati dhe nënshkrimi i ofertës

4.1.1. Në përputhje me VKM Nr. 130, datë 12.03.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të konçensionit/partneritetit publik-privat” dhe të VKM nr 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion/partneritet publik-privat” të ndryshuar, oferta duhet dërguar në format elektronik në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimeve Publike. Mund të gjeni informacion të plotë mbi këtë procedurë në faqen e internetit: www.app.gov.al.

4.1.2. Autoriteti Kontraktues nuk mban përgjegjësi ndaj çdo Ofertuesi, pretendimi apo ankese mbi pështjellime lidhur me dërgimin e Ofertës, përveç se në rast kur një ofertë nuk është marrë në mënyrën e përshtatshme për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme nga Autoriteti Kontraktues.

4.1.3. Në çdo rast, Ofertuesi duhet t’i dërgojë elektronikisht të gjitha informacionet e detyruara dhe të nevojshme për prezantimin e ofertave të tyre.

4.1.4. Ofertuesi i suksesshëm duhet ta dërgojë ofertën origjinale te Autoriteti Kontraktues. Oferta origjinale duhet të jetë brenda një zarfi/kutie të mbyllur dhe të vulosur. Emri dhe adresa e ofertuesit dhe shënimi: Ofertë për projektin “REHABILITIMI DHE VËNIA NË PUNË E TERMOCENTRALIT TË VLORË-S SI DHE TË NDËRTIMIT TË TUBACIONIT FIER-VLORË TË FURNIZIMIT ME GAZ TË TIJ”

Oferta origjinale do të dërgohet në adresën e mëposhtme:

I dërgohet:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Cc:	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Adresa:	Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë

4.2. Afati kohor për dërgimin e Ofertave

Ofertat do të dërgohen në faqen e internetit të APP-së brenda datës 22 Shkurt 2019, ora 12:00. Fituesi do të njoftohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

5. FILLIMI I OFERTAVE DHE VLERËSIMI

5.1. Fillimi i ofertave

5.1.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të bëjë verifikimin e ofertuesve dhe hapjen e ofertave që janë dërguar në faqen e internetit të APP-së pas përfundimit të afatit kohor për dërgimin e ofertave.

5.2. Vlerësimi i Ofertave

5.2.1. Pasi të jetë hapur oferta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do ta rishikojë atë për të përcaktuar nëse oferta është e pranueshme, nëse dokumentacioni i nevojshëm është dërguar, nëse dokumentacioni është nënshkruar drejt dhe nëse oferta është korrekte.

5.2.2. Vlerësimi i Autoritetit Kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe përmbajtjen e vetë ofertës dhe nëse e nevojshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë

sqarime nga Ofertuesit, të cilat nuk përbëjnë ndryshime në thelbin e Ofertës. Sqarimet do të jenë vetëm me shkrim ose/dhe të pasqyruara në minutat përkatëse. Gjithashtu, në raste të veçanta, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përfshijë ekspertë të ndryshëm të cilët mund të ndihmojnë në trajtimin e atyre rasteve që janë të vështira për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

5.2.3. Oferta do të konsiderohet e pavlefshme nëse:

- i) ofertuesi nuk ka dërguar Sigurimin e Ofertës;
- ii) oferta përmban të dhëna të rreme;
- iii) nuk ka përmbushur një ose të gjitha kërkesat e ftesës për procedurën e konkurrimit.

5.2.4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk e ndryshojnë thelbësisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e procedurës së përzgjedhjes apo gabime të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar brendinë e ofertës.

5.2.5. Nëse më shumë se një ofertë ka të njëjtën vlerë apo pikavarazh, atëherë ofertuesi duhet përcaktuar nëpërmjet një shorti në praninë e ofertuesve.

5.2.6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave drafton klasifikimin final që do të shpallet publikisht dhe do t'u komunikohet Ofertuesve. Pas shpalljes së klasifikimit final, çdo ofertues mund të pretendojë një rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur ai e konsideron se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në kontradiktë me Ligjin nr. 125/203 "Për konçesionet dhe partneritetin publik-privat" të amenduar dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion/partneritet publik-privat", të amenduar, duke përdorur formularin e Ankimit të Procedurës së Konkurrimit, siç tregohet në Shtojcën 21.

5.2.7. Pas përfundimit të procedurës së ankimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatit raportin final të vlerësimit të ofertës dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit Kontraktues rezultatet e arritura nga secili ofertues.

5.3. Pavlefshmëria dhe Dështimi i Procedurës së Konkurrimit

Procedura e Konkurrimit konsiderohet e pasuksesshme kur:

- i) Asnjë nga ofertat e dërguara nuk përmbush kërkesat e ftesës për një procedurë konkurruese;
- ii) Autoriteti Kontraktues shpall mbylljen e procedurës së konkurrimit për shkak të mungesës së përshtatshmërisë ekonomike të ofertave ose të vetë projektit.
- iii) Ose kur nuk ka pjesëmarrës në konkurs.

5.4. Veprime ilegale

Në përputhje me legjislacionin e parandalimit të konfliktit të interesit dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues refuzon një ofertë nëse ofertuesi i cili bën ofertën:

- i) I ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para ose jo, si një përpjekje për të influencuar veprimin ose vendimin ose zhvillimin e procedurës së konkurrimit;
Dhe/ose
- ii) Është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si – një ofertues ka një marrëdhënie me një person të natyrshëm ose person juridik i/e cili është emëruar nga Autoriteti Kontraktues për të dhënë shërbime konsulence gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose të dokumenteve të tjera lidhur me procedurën e

konkurrimit ose i/e cili ka një marrëdhënie me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- iii) Ka dhënë dokumente/informacion të rreme të cilat lidhen me kërkesat e parashtruara në Dokumentet Standarde të procedurës së konkurrimit.

Autoriteti Kontraktues e informon ofertuesin me shkrim dhe Agjencinë e Prokurimeve Publike për refuzimin e ofertës dhe për arsyet e këtij refuzimi dhe bën shënime relevante në raportin e procedurës së konkurimit.

5.5. Dizenjimi i Ofertës Fituese dhe Nënshkrimi i Kontratës

5.5.1. Pas skadimit të kohës së ankimimit që caktohet në klauzolën 5.2.6, Autoriteti Kontraktues do ta informojë Ofertuesin, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, nëpërmjet dërgimit të Njoftimit për Fituesin, sikundër përcaktohet në Formularin e Njoftimit të Fituesit. Një kopje më e detajuar e këtij njoftimi botohet në Fletoren e Njoftimeve Publike. Gjatë nënshkrimit, Autoriteti Kontraktues do ta pyesë Ofertuesin Fitues për dorëzimin e Sigurimit të Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës do të nënshkruhet dhe dorëzohet sipas klauzolës 5.5.3. Sigurimi i Kontratës në vlerë 10% të investimit të propozuar mund të dorëzohet në formën e një garancie të pakushtëzuar banke.

5.5.2. Autoriteti Kontraktues dhe Ofertuesi Fitues do të negociojnë në mirëbesim kushtet dhe afatet finale kohore të Kontratës së Konçesionit/Partneritetit Publi-privat, duke marrë parasysh se Ofertuesi Fitues duhet të nënshkruajë një Kontratë Konçesionare sipas Kushteve të Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontratës të nënshkruar nga ai në secilën nga faqet dhe të dorëzuar si pjesë të Ofertës Teknike, sikundër është amenduar (nëse e aplikueshme) gjatë procesit të negocimit të Kontratës Konçesionare/Partneritetit Publik-Privat.

5.5.3. Nëse brenda 30 ditësh afati kohor nga data e Njoftimit të Fituesit dhe nga afati kohor i caktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, bëhet e qartë se nëse Ofertuesi Fitues (për arsye të pajustificueshme) nuk do ta dorëzojë Sigurimin e Kontratës dhe/ose nuk do t'i nënshkruajë Kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontratës, Autoriteti Kontraktues do t'i mbajë Ofertuesit Fitues Sigurimin e Ofertës dhe do të ftojë Ofertuesit e tjerë sipas renditjes në klasifikimin final, deri sa të marrë Sigurimin e Kontratës dhe Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të nënshkruhen në secilën faqe nga Ofertuesit, sipas klasifikimit ose do të refuzojë të gjitha ofertat e tjera.

5.5.4. Autoriteti Kontraktues do të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e Konçesionarit dhe termat kryesore të Kontratës Konçesionare brenda 30 ditësh që nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shenim: Në rast të ndonjë mospërputhje midis dokumenteve të kësaj procedure konkurruese nga gjuha shqipe në atë angleze, atëherë do të prevalojë gjuha shqipe.

Shtojca 1: FORMULARI I OFERTËS

Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë

Subjekti: Ofertë e kompanisë/konsorciumit të përkohshëm të kompanive (*specifiko emrin e Ofertuesit*) për procedurën e konkurrimit “Rehabilitimi dhe Vënia në Punë e Termocentralit të Vlorë-s si dhe të ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë të furnizimit me gaz të TEC-it”

Data: ____ . ____ . ____

Formulari i ofertës është i përcaktuar si vijon:

		Kriteret e Vlerësimit	Njësia matëse	Vendos vlerën e ofertës ose referencën në materiale
1		Kriteri teknik		
	1.1	<ul style="list-style-type: none"> Plani operacional në lidhje me konceptin për riparimin, shndërrimin, kthimin funksional të TEC-it 	-	
	1.2	<ul style="list-style-type: none"> Projekt-ideja dhe plani operacional në lidhje me ndërtimin e tubacionit gazsjellës 	-	
	1.3	<ul style="list-style-type: none"> Tarifa e koncensionit (min. 2% e energjisë vjetore elektrike të prodhuar) 	%	
	1.4	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i ndikimit social dhe mjedisor 	-	
2		Kriteret financiare		
	2.1	<ul style="list-style-type: none"> Kostot e parashikuara të investimit për rivënien në funksion të TEC-it të Vlorës 	Euro	
	2.2	<ul style="list-style-type: none"> Kapitali i vet (equity) 	Euro	
	2.3	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro vjetore e vitit të fundit ushtrimor 	Euro	
3		Përvoja e ofertuesit në 7 vitet e fundit		
	3.1	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz 	MW	
	3.2	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera 	MW	
	3.3	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në tregtimin/shpërndarjen e energjisë elektrike 	MWh/vit	
	3.4	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në operimin dhe/ose mirëmbajtjen e impjanteve energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar 	Mw	
	3.5	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në tregtimin/shpërndarjen e gazit 	m³	
4		Koha për vënien në funksion të TEC		
	4.1	<ul style="list-style-type: none"> Koha për rikonstruksionin e TEC 	Muaj	
	4.2	<ul style="list-style-type: none"> Koha për ndërtimin e tubacionit të gazit 	Muaj	

Vlera totale e investimit (pa TVSH)
për rehabilitimin e TEC-it _____ EUR

Me fjalë: _____

Vlera totale e investimit (pa VAT)
për degën e tubacionit Fier-Vlora : _____ EUR

Me fjalë: _____

Shënim: *Ofertuesi nuk duhet të japë më shumë se një të dhënë për secilin nga kriteret, bazuar në projektin dhe planin e biznesit që ka paraqitur. Cmimet do të citohen në monedhën e Euros.*

Kini kujdes formulimin e ofertës. Nuk duhet të ketë alternative të formave të dorëzimit

- ❖ **Ju lutem gjeni të bashkëngjitur një propozim të detajuar (referencat e kapitujve janë shtuar në formularin e mësipërm).**

Emri dhe vula e ofertuesit

Shtojca 2: FTESA PËR OFERTË

(Emri i Autoritetit Kontraktues)

Fton të dorëzoni oferta për implementimin e punëve të mëposhtme:

.....
.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të gamës së kontratës dhe sasisë, sikundër përcaktohet në Dokumentacionin Standard të Konçesioneve dhe partneritetit publik-privat (Dokumentat Standarde të Konçesionit/PPP).

Vendi i ekzekutimit të kontratës

(jep një përshkrim të shkurtër)

Termat e ekzekutimit të kontratës _____

Oferta duhet dorëzuar

.....

...[Jep adresën e saktë]

Para

.....

[Specifiko datën dhe kohën e afatit final kohor]

Nëse oferta kërkohet të dorëzohet elektronikisht, operatorët ekonomikë duhet ta dorëzojnë ofertën elektronikisht në faqen e internetit të APP-së, www.app.gov.al

[Dokumenti që mban kokën e letrës së Bankës]
[Për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

Shtojca 3: FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Proçedura e konçesionit/partneritetit publik-privat [lloji i proçedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Fushëveprimi]

Publikimi (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Numri i referencës në faqen e internetit të APP-së

Referuar proçedurave të lartpërmendura,

Ne, garantojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka paguar një depozitë në [emri dhe adresa e bankës/kompanisë së sigurimit] në vlerën [monedha dhe çmimi i shprehur në fjalë dhe numra] si një kërkesë për sigurimin e ofertës, të dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Ne garantojmë të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktues] vlerën e siguruar, brenda një periudhe kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga një kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë, pa kërkuar shpjegime, duke dhënë që një kërkesë e tillë përmend mospërmbyshjen e një prej kërkesave të mëposhtme:

- Ofertuesi e tërheq ofertën gjatë proçedurës së konkurrimit para skadimit të vlefshmërisë së ofertës;
- Ofertuesi nuk paraqet Sigurimin e Kontratës (në rast të shpalljes së fituesit);
- Ofertuesi nuk e nënshkruan kontratën konçesionare (në rast të shpalljes së fituesit) brenda afateve kohore të specifikuar në Formularin e Njoftimit të Fituesit;
- Ofertuesi ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;
- Në rast të shpalljes së fituesit, Ofertuesi do të refuzojë pagesën e shpenzimeve sipas paragrafit 1.4 të Dokumenteve Standarde të Proçedurës së Konkurrencës.

Ky Sigurim do të jetë i vlefshëm [njoftimi i kontratës ose ftesa për ofertë/tender] ditë nga data e skadimit të termave të dorëzimit të ofertës në faqen e internetit të APP-së.

[përfaqësuesi i bankës/i kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4: LISTA E INFORMACIONT KONFIDENCIAL

[Për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Specifiko informacionin e mëposhtëm që dëshiron të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që do të mbahet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat/artikujt e Dokumenteve Standarde të Konçesionit /PPP, që dëshiron të mbahen konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet mbajtur konfidencial	Afati kohor brenda të cilit një informacion i tillë duhet mbajtur konfidencial

[Për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

Shtojca 5: DEKLARATA E PËRMBUSHJES SË KËRKESAVE TË DOKUMENTEVE STANDARDE TË KONÇESIONIT /PARTNERITETIT PUBLIK-PRIVAT

të operatorit ekonomik që merr pjesë në procedurën e konçesionit/partneritetit publik-privat që zhvillohet në _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ lidhur me _____

Unë, i nënshkruari _____, në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik, _____ deklaroj këtu se:

Ne i plotësojmë të gjitha specifikimet teknike që parashtrihen në dokumentet e Konçesionit/Partneritetit Publik-Privat dhe i pranojmë ato pa asnjë rezervë dhe vërejtje. Ne deklarojmë me përgjegjësi ligjore se biem dakord me të gjitha specifikimet e dhëna teknike dhe i plotësojmë ato sikundër janë përcaktuar në dokumentet e Konçesionit/Partneritetit Publik-Privat. Ne i plotësojmë të gjitha kërkesat ligjore, financiaro-ekonomike dhe specifikimet teknike që parashtrihen në dokumentet standarde të procedurës së konkurrimit dhe çertifikojmë me çertifikata dhe dokumente përkatëse që janë dorëzuar së bashku me deklaratën aktuale.

Oferta jonë do të jetë e vlefshme për periudhën e specifikuar në dokumentet e kontratës standarde për procedurën e konkurrimit.

Ne nuk do të marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë për këtë procedurë konkurrimit.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktues të verifikojë informacionin/dokumentet e bashkëngjitura të këtushme.

Nëse oferta jonë do të pranohet, ne do të bëjmë sigurimin e kontratës, sikundër kërkohet në dokumentet e kontratës standarde.

Nëse ne shpallemi fitues të procedurës së konkurrimit, ne do të pranojmë ta nënshkruajmë Kontratën sipas termave të kontratës.

Data e dhënies së deklaratës _____

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6: DEKLARATA mbi konfliktin e interesave

të operatorit ekonomik që merr pjesë në procedurën e konçesionit/partneritetit publik-privat që do të zhvillohet në _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ lidhur me _____

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zv kryeministri, ministri, ose zvmministri, Deputeti, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë, i nënshkruari _____, në cilësinë e përfaqësuesit të entit ligjor legal entity, _____ deklaroj me përgjegjësinë time personale se:

Unë jam i njohur (**aware**) me kërkesat dhe ndalimet e parashtruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike" i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra për zbatim të këtij ligji nga Inspektori i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Aseteve dhe Ligji nr. 125/2013 "Për konçesionet/partneritetin publik-privat".

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dhënies së deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

[Për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

Shtojca 7: FORMULARI I VLERËSIMIT

(Ky formular aplikimi do të shoqërohet nga Akti i Testimit dhe situatat financiare)

Autoriteti Kontraktues /Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Zyrtarit të Lartë /Administratori	
UNË GARANTOJ SE:	
Autoriteti kontraktues /Investitori ka nënshkruar një kontratë me	
Emri i Operatorit Numri i Identifikimit të Taksapaguesit/	
Konsorciumi i Operatorëve Numri i Identifikimit të Taksapaguesit /	
Numri i Identifikimit të Nënkontraktuesit të Taksapaguesit	
Adresa/t	
Fushëveprimi i kontratës :	
Data e fillimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e konsorciumit të Operatorëve Ekonomikë dhe përshkrimit të punëve që do të bëhen nga secili anëtar	
Vlerësimi	(e shprehur në fjalë)
	Zbatuar
	Pazbatuar
Nënshkrimi	
Vula e Autoritetit Kontraktues	

[Për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

Shtojca 8: MBI ZOTËRIMIN E MAKINERIVE

Operatori Ekonomik: _____

Unë deklaroj se i zotëroj mjetet, pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën si vijon: _____

Në pronësi				
Lloji i automjetit	Targa	Numri i Lejes së Qarkullimit	Numri i shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

dhe

Me qira					
Lloji i mjetit	Targa e automjetit	Numri i Lejes së Qarkullimit të automjetit	Numri i shasisë së automjetit	Numri i kontratës së qirasë (zyra e noterit)	Termet e kontratës me qira (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/hiq rreshta të tjerë nëse e nevojshme.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktues ta kontrollojë informacionin e dhënë në këtë kuti (table).

PERSONI KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Numri i telefonit:

Faksi:

Posta elektronike:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9: KRITERET E KUALIFIKIMIT

PRANIM I PËRGJITHSHËM /KRITERET E KUALIFIKIMIT

Kandidati / Ofertuesi do të dorëzojë (submit):

1. Një dokument që dëshmon se (entiteti juaj):

a) nuk është në proçes falimentimi,

b) nuk është dënuar për vepër penale, sipas Nenit 45/1 të PPL,

c) nuk është dënuar, si rrjedhojë e vendimit final të gjykatës lidhur me veprimtarinë profesionale, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Kërkesat e mësipërme plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të të Dhënave Tregtare për të Dhënat e Entit, Ekstraktin mbi Historinë e Entit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe vetëdeklarimin e entit, sipas Shtojcës nën Numrit Extra të "Deklaratës së të Dhënave Gjyqësore".

2. Një dokument që dëshmon se subjekti (your entity):

a) ka përmbushur detyrimet fiskale,

b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e pranimit të përgjithshëm nuk do të ndryshohen nga autoritetet kontraktuese. Këto kritere (pikat 1.2) duhet të provohen përmes dokumenteve të lëshuara jo më herët se tre muaj nga data e hapjes së ofertave.

3. Operatori ekonomik duhet të regjistrohet me regjistrin përkatës profesional ose tregtar të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë qëllim, kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të ekstraktit historik të subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Kandidati / ofertuesi i huaj do të provojë se i plotëson të gjitha kërkesat e lartpërmendura. Nëse dokumentet e lartpërmendura nuk lëshohen në vendin e tyre të origjinës, atëherë një deklaratë me shkrim do të jetë e mjaftueshme. Nëse gjuha e përdorur në proçedurë është shqip, atëherë dokumentet e gjuhëve të huaja duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rast konsorciumi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të dorëzojnë dokumentet e lartpërmendura.

Përveç kësaj, nëse oferta është dorëzuar nga një konsorcium i operatorëve ekonomikë, duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

- a. Marrëveshja e Noterizuar, sipas së cilës është themeluar zyrtarisht konsorciumi i operatorëve ekonomikë;
- b. Prokura e veçantë e Avokatit.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomik janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e ofertës, në përputhje me Shtojcën 3;

b. Një deklaratë për përmbushjen e kërkesave të dokumenteve standarde të konçesionit / partneritetit publik privat, në përputhje me Shtojcën 5;

c. Një Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, në përputhje me Shtojcën 6;

d. Një Përshkrimi i Ofertës është plotësuar dhe nënshkruar siç duhet, në përputhje me Shtojcën 1;

e. Një formular vlerësimi në përputhje me Shtojcën 7 ;

f. Një deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve, në përputhje me Shtojcën 8

2. Për të vërtetuar se operatorët ekonomik janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë si vijon:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik

1. Regjistrimi si person juridik. Ekstraktin e regjistrimit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
2. Numri i Identitetit të Tatimpaguesit;
3. Një dokument që vërteton se aksionet / pasuritë e subjektit tuaj nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor ose nuk ka urdhër të sekuestrimit kundër tyre, të lëshuar nga Zyra e Përmbarimit në qytet, aty ku ju keni selinë tuaj qendrore;
4. Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka përmbushur detyrimet fiskale, të lëshuara nga Administrata Tatimore;
5. Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuara nga Administrata Tatimore;
6. Një vërtetim që vërteton shlyerjen e të gjitha tarifave të energjisë elektrike të maturuara të kontratave të energjisë të operatorit ekonomik të regjistruar në Shqipëri. Dështimi për të paguar faturat e energjisë elektrike është shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç nëse rezulton se pagesat e papaguara të energjisë elektrike, siç konfirmohet në çertifikatën e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces të apelimit në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar ta lëshojë këtë çertifikatë jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga operatori ekonomik.

Kriteret e mësipërme plotësohen vetëm nëse dokumentet e dorëzuara janë kopje origjinale ose të noterizuara.

Kompanitë konkurruese regjistrohen në regjistrat përkatës profesional ose tregtar të shtetit në të cilin janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë qëllim, ofertuesit duhet të dorëzojnë **ekstraktin historik, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.**

Ofertuesi i huaj (një kompani e regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë) duhet të provojë se i plotëson të gjitha kërkesat e lartpërmendura. Nëse dokumentet e lartpërmendura nuk janë lëshuar në vendin e origjinës së ofertuesit, ato do të pranohen në formën e një deklaratë të shkruar, nën përgjegjësinë e ofertuesit (sipas formularit të paraqitur në Shtojcën 11). Lidhur me deklarimin e moslëshimit të këtyre çertifikatave nga institucionet e shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të dorëzojnë një çertifikatë nga Dhoma e Tregtisë e vendit të origjinës - duke vërtetuar faktin se një ose të gjitha çertifikatat e kërkuara në këtë Shtojcë janë nuk lëshohet nga asnjë institucion publik përgjegjës. Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do të hetojë nëse këto çertifikata lëshohen ose jo nga institucionet përkatëse në vendin e origjinës dhe, nëse është vërtetuar zyrtarisht se në vendin e origjinës ekziston një institucion që mund të lëshojë një vërtetim të tillë të paraqitur nga ofertuesi i huaj në formën e vetëdeklarimit, atëherë Komisioni do ta konsiderojë dokumentin e vetëdeklarimit të pavlefshëm.

Në rast se Impiantet operohen nga shoqëri anëtare të grupit të Ofertuesit, ky i fundit duhet të paraqesë strukturën e shoqërisë të evidentuar me dokumenta.

Në rastin e eksperiencës së fituar (qoftë kjo në lidhje me ndërtimin e Impiantit, operimin e tij, apo me tregtimin ose distribucionin e energjisë elektrike) apo Impiantet e operuara nga një shoqëri tjetër e cila i përket Grupit të Aplikantit, të Ofertuesit. Ofertuesi do të paraqesë

dokumenta që provojnë (evidentojnë) strukturën e shoqërisë së Grupit të Aplikantit. Grup i Aplikantit do të konsiderohet çdo korporatë, shoqëri, entitet ligjor, i cili (i) direkt apo indirekt Kontrollon Ofertuesin / Aplikantin; ose (ii) direkt apo indirekt Kontrollohet, apo zotërohet nga Aplikanti / Ofertuesi; ose (iii) direkt apo indirekt zotërohet me 50% apo më shumë nga Aplikanti / Ofertuesi; ose (iv) zotërohet direkt apo indirekt nga i njëjti entitet ligjor, që Kontrollon Aplikantin / Ofertuesin. Për më tepër, termi “Kontroll” i një koorporate, shoqërie, apo entiteti ligjor do të thotë që në mënyrë direkte apo indirekte të ketë shumicën e kuotave, aksioneve, apo njësive dhe fuqinë / të drejtën për të drejtuar apo shkaktuar drejtimin e politikave drejtuese të një koorporate, shoqërie, apo entiteti tjetër ligjor. Në çdo rast edhe nëse lidhja e tyre provohet nga dokumentacioni i mësipërm, shoqëritë do të shprehen me vendimet e organeve drejtuese ose vendimmarrëse me datë jo më të hershme se data e publikimit të njoftimit të kontratës ose njoftimit në gazetën ndërkombëtare, ku të jetë cilësuar qartë objekti i tenderit si dhe përgjegjësia solidare përpara AK-së, sipas përcaktimit të statuteve të shoqërive të grupit i cili duhet të jetë bashkelidhur, (asamble e zakonshme ose e jashtë zakonshme e ortakëve) kooproate, shoqërie, apo entiteti tjetër ligjor.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet i noterizuar nga vendi origjinës si dhe i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e konsorciumit të përkohshëm të kompanive, kërkesat e Shtojcës 11 do të jenë të detyrueshme për secilin nga anëtarët e këtij konsorciumi.

Legalizimi i dokumentacionit

Dokumentet e marra jashtë territorit të Shqipërisë nga persona juridikë të huaj duhet të legalizohen për të patur një vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga kompanitë e regjistruara në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 tetor 1961) duhet të mbajë vulën e Apostilit në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për pranimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaj".

Bashkimi i përkohshëm i kompanive

Operatorët Ekonomikë mund të konkurrojnë veçmas ose të krijojnë grupe të operatorëve ekonomikë dhe të ofrojnë si kandidatë të vetëm.

Oferta mund të dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, njëri prej të cilëve përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast të përzgjedhjes, gjithashtu gjatë zbatimit të kontratës.

Përpara paraqitjes së ofertave, bashkimi i përkohshëm do të formohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar që specifikon përfaqësuesin e grupit, përqindjen e pjesëmarrjes të secilit anëtar dhe përbërësit specifik që duhet të kryhen nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi të përkohshëm. Mirëbesimi për të hyrë në një marrëveshje të bashkimit të përkohshëm të kompanive duhet të manifestohet qartë me vendim të organit vendimmarrës të të gjitha kompanive pjesëmarrëse në kontratën e përkohshme të bashkimit. Për të provuar se cili është organi vendimmarrës në këtë bashkim të përkohshëm të kompanive, do të paraqitet statuti aktual i secilës prej kompanive pjesëmarrëse në këtë bashkim të përkohshëm.

Pas themelimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit, nëpërmjet prokurës, caktojnë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertave. Kjo marrëveshje e shkruar dhe

prokurora duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, që duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi gjithashtu do të bëjë Sigurimin e Ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomik.

Duke marrë parasysh përqindjet e pjesëmarrjes së kompanive të përcaktuara në Kontratën e Përkohshme të Bashkimit, të gjitha kompanitë që marrin pjesë në bashkim të përkohshëm do të jenë përgjegjëse bashkarisht dhe individualisht tek Autoriteti Kontraktues në lidhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në Kontratën e Konçesionit. Për këtë arsye, një deklaratë e tillë (me përmbajtjen e mësipërme) duhet të formulohet qartë nga të gjitha kompanitë pjesëmarrëse në bashkimin e përkohshëm, ose në Kontratën e Përkohshme të Bashkimit ose në prokurorën për përcaktimin e përfaqësuesit të tyre.

Në çdo rast edhe nëse lidhja e tyre provohet nga dokumentacioni i mësipërm, shoqëritë anetare të Bashkimit të përkohshëm, do të shprehen me vendimet e organeve drejtuese ose vendimmarrëse me datë jo më të hershme se data e publikimit të njoftimit të kontratës ose njoftimit në gazetën ndërkombëtare, ku të jetë cilësuar qartë objekti i tenderit si dhe përgjegjësia solidare përpara AK-së, sipas përcaktimit të statuteve të shoqërive të grupit i cili duhet të jetë bashkelidhur, (asamble e zakonshme ose e jashtë zakonshme e ortakëve) koorproate, shoqërie, apo entiteti tjetër ligjor.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet i noterizuar nga vendi origjinës si dhe i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.

Nëse bashkimi i operatorëve ekonomik është deklaruar si fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të bashkimit.

Çdo operator ekonomik duhet të pajtohet me kërkesat ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e ofertës / tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike duhet të plotësohen nga i gjithë grupi së bashku.

Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të dorëzojë njëkohësisht oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertave tjera, përndryshe oferta e tij do të refuzohet.

Në rastin e falimentimit të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomik ose në rrethana të tjera që ndërpresin aktivitetin e tij gjatë kryerjes së kontratës, autoriteti kontraktues mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik të caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga përfaqësuesi anëtarët e tjerë jo-përfaqësues, me kusht që të ketë kapacitetin ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik për ekzekutimin e kontratës; ndryshe, autoriteti kontraktues mund të tërhiqet nga kontrata. Nëse këto rrethana aplikohen tek operatori tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk arrin të emërojë një zëvendësues atëherë detyrimet e operatorit ekonomik të dështuar mund të ndërmerren nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që të përmbushë kërkesat përkatëse.

Kompanitë shqiptare do të jenë subjekt i rregullave të parashikuara nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar. Në rastin e kompanive të huaja, do të respektohen standardet ligjore për shoqëritë tregtare në vendin e origjinës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi do të ketë burimet financiare të nevojshme për ekzekutimin e fushës së konkurrencës dhe duhet të mbajë çdo rrezik që mund të lindë, siç parashikohet ose nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe të Specifike të Kontratës.

Për t'u kualifikuar, operatori ekonomik duhet të plotësojë **njëkohësisht kriteret** e mëposhtme:

1. Xhiro vjetore e vitit të fundit ushtrimor duhet të jetë sa 2-fishi i investimit total (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.
2. Kapitali i vet (totali i aktiveve minus detyrimi total) i vitit të fundit fiskal (2017) duhet të jetë së paku i barabartë me 50% të vlerës totale të investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.
3. Fitimi neto i vitit të fundit fiskal (2017) duhet të jetë së paku i barabartë me 50% të vlerës totale të investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.

dhe **duhet domosdoshmërisht** të paraqesë 1 ose më shumë dokumente bankare në emër të kompanisë, të cilat, të marra në total, të provojnë se kompania zotëron jo më pak se 10 % të vlerës së përgjithshme të investimit (pa TVSH) të propozuar personalisht nga ofertuesi. Data e lëshimit të tyre (dokumentet bankare) nuk duhet të jetë më herët se 10 ditë nga afati i caktuar i dorëzimit të ofertës. Dështimi për të paraqitur këtë / këto dokumente do të përbëjë arsye për skualifikim.

Dokumentet që dëshmojnë burime të mjaftueshme financiare përfshijnë:

- a. Kopjet të bilancit të dy viteve të fundit (2016 dhe 2017) që janë paraqitur në administratën tatimore dhe,
- b. Raportet e auditimit financiar (2016-2017), (duke përfshirë opinionin e auditorit), të çertifikuara nga një subjekt i jashtëm i licencuar i auditimit dhe,
- c. Çertifikatat vjetore të xhiros të dy viteve të fundit (2016 dhe 2017) të lëshuara nga administrata tatimore, ku kompania ka selinë e saj zyrtare.
- d. Dokumentet bankare për të vërtetuar gjendjen financiare të kompanisë.

Ofertuesi duhet të informojë Autoritetin Kontraktues për këtë procedurë konkurruese për të gjitha kontratat që Ofertuesi ka lidhur me të. Në rast se Ofertuesi është një Konsorcium i Përkohshëm, kjo vlen për çdo anëtar të Konsorciumit të tillë.

Për llogaritjen e vlerës së investimit për përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe financiar, vlera e investimit do të llogaritet në bazë të vlerësimeve të paraqitura (dizajni teknik dhe plani i biznesit).

Kursi zyrtar i këmbimit në datën e publikimit të ftesës për ofertë në faqen e internetit të APP-së do të zbatohet. Kursi zyrtar i këmbimit është i publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

2.3. Kapaciteti teknik:

Ofertuesit duhet të plotësojnë kërkesat teknike për kualifikim dhe të dorëzojnë si më poshtë:

Sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, ofertuesi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e përfundimit të punimeve ose ekuivalentin e tyre i cili vërteton se ofertuesi ka ndërtuar brënda 7 viteve të fundit dhe vënë në punë

impjant/impjante me fuqi të instaluar të cilat në total të jenë jo më pak se 500 MW. Për të shmangur çdo keqkuptim ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion për impjante të ndërtuar të paktën një kontratë me fuqi të instaluar jo më pak se 100 MW.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton se operon dhe/ose mirëmban një ose më shumë impiante energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar me kapacitet jo më të vogël se 100 MW.
3. Mjetet, pajisjet teknike në dispozicion ose që mund të vihen në dispozicion të ofertuesit në përputhje me Shtojcën 8.

ANALIZA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

Analiza ekonomike dhe financiare është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe objektivi kryesor është përcaktimi i "vlerës së parasë" të projektit. Ajo mund të hartohet nga çdo person fizik apo entitet juridik vendas ose i huaj, ose nga vetë ofertuesi.

Analiza ekonomike dhe financiare e paraqitur nga ofertuesi për procedurën konkurruese duhet të strukturohet në mënyrën e mëposhtme:

a. Punimet e investimeve të drejtpërdrejta (Vlerësimi i Kostos).

Përveç vlerësimit të koston analitike të dizajnuar nga inxhinieri përkatës, shpenzimet e investimeve direkte për TEC-in e Vlorës duhet të përfshijnë edhe

- Rehabilitimin
- Operimet
- Mirëmbajtjen

b. Metoda e financimit të investimeve (burimet e financimit).

- ___% e vlerës së investimit që do të financohet nga kapitali i kompanisë/ve;
- ___% e vlerës së investimit do të financohet nga kapitali i jashtëm;

c. Kërkesat dhe afati kohor i shlyerjes së kredisë (opsionale).

- Periudha e shlyerjes;
- Norma e interesit;
- Koha e fillimit të shlyerjes së kredisë;

d. Kostot indirekte të projektit.

Këto kosto do të përfshijnë, pa kufizim, koston e personelit që merret me administrimin, shpenzimet e sigurimit etj. Më tej, amortizimi vjetor i termocentralit do të llogaritet.

e. Të ardhurat e krijuara nga shitjet e energjisë elektrike.

- Prodhimi mesatar vjetor;
- Kostot e energjisë elektrike;
- Kostot e konvertimit (1m^3 gas in KW/h);

f. Deklarata e "të ardhurave dhe shpenzimeve" duhet të hartohet bazuar në treguesit e mësipërm, duke theksuar fitimin e afatit, si dhe deklaratën e flukseve monetare

- Pasqyra e fluksit monetar duhet të përfshijë të gjithë periudhën e dhënies së konçesionit.

g. Fizibiliteti ekonomik i projektit do të pasqyrohet nga treguesit e mëposhtëm të performancës financiare.

- Vlera Neto Aktuale (VNA);
- Norma e Brendshme e Kthimit të projektit (IRR);
- Periudha e kthimit (PBP);

Në llogaritjen e këtyre treguesve, referencat e normës së zbritjes në rastin bazë për aktualizimin e "parasë" duhet të paraqiten qartë.

h. Analiza e ndjeshmërisë.

Analiza e ndjeshmërisë e prezanton informacionin në një mënyrë që lejon të kuptuarit saktësisht se çfarë supozohet si një kërkesë themelore dhe se si rezultatet përfundimtare do të ndikohen nga ndryshimet në supozime të ngjashme. Kjo arrihet duke kryer analiza të ndryshme të ndjeshmërisë dhe duke krahasuar rezultatet me ato që bazohen në supozime të ndryshme rreth gjendjes bazë dhe më konkretisht duke kryer analizën e ndjeshmërisë për treguesit e performancës ku:

- Prodhimi mesatar vjetor i energjisë elektrike ndryshon me $\pm 30\%$ (pa kufizimet fizike);
- Investimi fillestar ndryshon me $\pm 20\%$;
- Norma e aktualizimit ndryshon me ± 2 points %;
- Çmimet e energjisë elektrike ndryshojnë me $\pm 10\%$;

Shënim: Në rastet kur, pas analizës ekonomike dhe financiare të dizenuara për rastin bazë dhe / ose kur, sipas analizës së ndjeshmërisë rezulton se një investim i tillë nuk është i realizueshëm, oferta do të konsiderohet e pavlefshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje origjinale ose të noterizuara. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose studimi, sipas kërkesave të përcaktuara në këto Dokumente Standarde të Proçedurës Konkurruese, ose dokumentet e rreme dhe të pasakta konsiderohen si bazë për skualifikim.

Shtojca 10: DEKLARATA E DËSHMISË SË PENALITETIT

Nga operatori ekonomik që merr pjesë në procedurën e konçesionit për t'u mbajtur në _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ lidhur me _____

Unë, nënshkruesi _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, deklaroj se:

Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për vepra penale /shkelje sipas nenit 45/1 të Ligjit të Prokurimit Publik,

Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës lidhur me aktivitetin profesional,

Data e dorëzimit të deklaratës _____

**Përfaqësuesi i ofertuesit
Nënshkrimi**

Vula

Shtojca 11: KRITERET E VLERESIMIT

Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme dhe fituesi, i cili ka arritur numrin më të madh të pikëve në bazë të kriterëve të vlerësimit, do të konsiderohet fitues.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertës do të vlerësojë ofertat teknike dhe financiare në bazë të kriterëve të mëposhtme:

Metodologjia e vlerësimit

	Kriteret e Vlerësimit	Pikët maksimale	Metodologjia e vlerësimit
1	Kriteri teknik	40	
1.1	<ul style="list-style-type: none"> Plani operacional për riparimin, shndërrimin, kthimin funksional të Tec-it 	10	-
1.2	<ul style="list-style-type: none"> Plani operacional në lidhje me ndërtimin e tubacionit gazsjellës 	10	-
1.3	<ul style="list-style-type: none"> Tarifa e koncensionit (min. 2% e energjisë vjetore elektrike të prodhuar) 	5	$P_i = \frac{Fee_i}{Fee_{max}} \times 5$
1.4	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i ndikimit social dhe mjedisor 	15	-
2	Kriteret financiare	30	
2.1	<ul style="list-style-type: none"> Kostot e parashikuara të investimit për rivënien në funksion të TEC-it të Vlorës 	20	$P_i = \frac{C_i}{C_{max}} \times 20$
2.2	<ul style="list-style-type: none"> Kapitali i vet (equity) 	5	$P_i = \frac{E_i}{E_{max}} \times 5$
2.3	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro vjetore e vitit të fundit ushtrimor 	5	$P_i = \frac{X_i}{X_{max}} \times 5$
3	Përvoja e ofertuesit në 7 vitet e fundit	23	
3.1	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz 	8	$P_i = \frac{Png_i}{Png_{max}} \times 8$
3.2	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjise me burime të tjera 	3	$P_i = \frac{Pne_i}{Pne_{max}} \times 3$
3.3	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në tregtimin e energjisë elektrike 	3	$P_i = \frac{Pte_i}{Pte_{max}} \times 3$
	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në operimin dhe/ose mirëmbajtjen e impjanteve energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar 	6	$P_i = \frac{Pot_i}{Pot_{max}} \times 6$
3.5	<ul style="list-style-type: none"> Përvoja në tregtimin/shpërndarjen e gazit 	3	$P_i = \frac{Ptg_i}{Ptg_{max}} \times 3$
4	Koha për vënien në funksion të TEC	7	
4.1	<ul style="list-style-type: none"> Koha për rikonstruksionin e TEC 	5	$P_i = \frac{R_{min}}{R_i} \times 5$
4.2	<ul style="list-style-type: none"> Koha për ndërtimin e tubacionit të gazit 	2	$P_i = \frac{G_{min}}{G_i} \times 2$
	Gjithsej	100	

Ku:

i	- Tregues i ofertuesit
P_i	- Pikat e llogaritura të ofertuesit (i);
Fee_i	- Tarifa konçesionare (i) (sasia e energjisë elektrike që korrespondon me

Fee_{max}	përqindjen e shprehur); - Tarifa maksimale e konçesionit (shuma e energjisë elektrike që korrespondon me përqindjen e shprehur);
C_i	- Investimi i ofertuesit
C_{min}	- Investimet minimale të ofruara
E_i	- Kapitali i vitit të fundit të shoqërisë e identifikuar në bilanc
E_{max}	- Kapitali më i madh i vitit të fundit të shoqërisë e identifikuar në bilanc
Png_i	- Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz në MW e shoqërisë
Png_{max}	- Përvoja maksimale e ofruar në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz në MW
Pne_i	- Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera në MW e shoqërisë
Pne_{max}	- Përvoja maksimale e ofruar në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera në MW
Pte_i	- Përvoja në tregtimin/ shpërndarjen e energjisë elektrike në MW e shoqërisë
Pte_{max}	- Përvoja maksimale e ofruar në tregtimin/ shpërndarjen e energjisë elektrike në MW
Ptg_i	- Përvoja në tregtimin/ shpërndarjen e gazit në m^3 e shoqërisë
Ptg_{max}	- Përvoja maksimale e ofruar në tregtimin/ shpërndarjen e gazit në m^3
R_i	- Kohëzgjatja e përgjithshme e ofertuesit deri kur TEC i Vlorës të jetë funksional
R_{min}	- Kohëzgjatja minimale totale e punimeve të ndërtimit deri kur TEC i Vlorës të jetë funksional
G_i	- Kohëzgjatja e përgjithshme e ofertuesit deri kur tubacioni i gazit të jetë funksional
G_{min}	- Kohëzgjatja minimale totale e punimeve të ndërtimit deri kur tubacioni i gazit të jetë funksional
X_i	- Xhiro vjetore e vitit të fundit ushtrimor e ofertuesit
X_{max}	- Xhiro vjetore maksimale e vitit të fundit ushtrimor
Pot_i	- Përvoja në operimin dhe/ose mirëmbajtje të impjanteve energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar e ofertuesit
Pot_{max}	- Përvoja më e madhe e ofruar në operimin dhe/ose mirëmbajtje të impjanteve energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar termo

Kriteret e përcaktuara në Ofertë përbëjnë kushtet e panegociueshme të Kontratës së Konçesionit dhe nuk mund të ndryshohen.

Shpjegimet e kriterëve të vlerësimit:

- ***Plani operacional në lidhje me konceptin për riparimin, kthimin funksional të TEC-it***

Ofertuesi duhet të paraqesë një plan të detajuar teknik të shoqëruar me vizatimet përkatëse, duke përfshirë por pa u kufizuar, të gjitha veprimet operationale që do të ndërmerren nga subjekti në funksion të realizimit të objektit të konçesionit për riparimin e pjesëve të difektuara gjatë testimeve dhe konservimit, shndërrimin e funksionimit të tij nga puna me lëndë djegëse nafte, në punë me lëndë djegëse të gazit natyror dhe vënien në punë të TEC-it.

Ofertuesi i cili paraqet planin operacional në lidhje me konceptin për riparimin, shndërimin me gaz, kthimin funksional të TEC-it plotë në përputhje me praktikën dhe standartet më të mira industriale ndërkombëtare, do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Plani operacional në lidhje me ndërtimin e tubacionit gazsjellës***

Ofertuesi duhet të paraqesë një plan të detajuar teknik të shoqëruar me vizatimet përkatëse dhe me detajime grafike, duke përfshirë por pa u kufizuar, të gjitha veprimet operationale që do të ndërmerren nga subjekti në funksion të lidhjes së TEC-it me tubacionin kryesor të TAP për furnizimin e TEC-it me gaz, sipas EU standart.

Ofertuesi i cili paraqet planin operacional të lidhjes së TEC-it me tubacionin kryesor të TAP për furnizimin e TEC-it me gaz, sipas EU standart si dhe bazuar në praktikën të mira industriale ndërkombëtare, do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Tarifa e konçensionit (min. 2% e energjisë vjetore elektrike të prodhuar)***

Tarifa e konçensionit nënkupton detyrimin e konçesionarit për të dhënë energji elektrike pa shpërblim (të shprehur në %), në favor të Autoritetit Kontraktues. Sasia minimale e ofruar është 2% e energjisë elektrike të prodhuar gjatë një viti, por jo më pak se energjia vjetore që do të prodhohet e deklaruar në ofertë. Ofertuesi i cili ofron një sasi më të vogël se 2% e energjisë elektrike të prodhuar do të skualifikohet.

Ofertuesi i cili ofron % më të lartë të prodhimit vjetor të energjisë do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Vlerësimi i ndikimit social dhe mjedisor***

Do të vlerësohet me pikët maksimale paraqitja e një plani monitorimi të masave zbutëse në lidhje me ndikimin që vepra energjetike do të ketë në mjedis (florën, faunën, token, ujën, ajrin) si dhe në mikroklimën e ambientit. - **10 pike**

Investime shtesë të parashikuara në ndihme të infrastrukturës së zonës. - **5 pike**

Shënim: Informacioni dhe çështjet që duhet të trajtohen në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis përshkruhen Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis“ si dhe në kërkesat e tjera ligjore bazuar në kuadrin ligjor rregullator të mjedisit.

Megjithatë në raportin VNM mund të trajtohen edhe çështje të tjera të identifikuar gjatë plotësimit të saj.

- ***Kostot e parashikuara të investimit për rivënien në funksion të TEC-it të Vlorës***

Ofertuesi i cili paraqet vlerën më të lartë të kostove të parashikuara për vënien në punë të TEC-it të Vlorës (përfshirë dhe ndërtimin e tubacionit) do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Kapitali i vet (equity)***

Ofertuesi i cili paraqet në pasqyrat financiare të vitit të fundit ushtrimor, kapitalin e shoqërisë (vlera e përgjithshme e asetëve minus të gjitha detyrimet) në vlerën më të lartë do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Xhiro vjetore e vitit të fundit ushtrimor***

Ofertuesi i cili paraqet në pasqyrat financiare të vitit të fundit ushtrimor vlerën e xhiros vjetore më të lartë do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz***

Ofertuesi duhet të paraqesë çertifikata të përfundimit të punimeve ose ekuivalentin e tyre ku të vërtetojë dorëzimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz të ndërtuar brenda 7 viteve të fundit, në të cilën të shprehet dhe fuqia e instaluar në MW.

Ofertuesi i cili ofron fuqinë më të lartë të ndërtuar të impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz brenda 7 viteve të fundit, do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Përvoja në ndërtimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera***

Ofertuesi duhet të paraqesë çertifikata të përfundimit të punimeve ose ekuivalentin e tyre ku të vërtetojë dorëzimin e impjanteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera të ndërtuar brenda 7 viteve të fundit, në të cilën të shprehet dhe fuqia e instaluar në MW.

Ofertuesi i cili ofron fuqinë më të lartë të ndërtuar të impjanteve për prodhimin e energjisë me burime të tjera brenda 7 viteve të fundit, do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Përvoja në operimin dhe/ose mirëmbajtje të impjanteve energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar***

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion përkatës që vërteton operimin dhe/ose mirëmbajtjen e impjanteve energjitike me turbinë gazi me cikël të kombinuar. Ofertuesi i cili aktualisht operon dhe mirëmban impjante me fuqi të instaluar më të madhe do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Përvoja në tregtimin/shpërndarjen e energjisë***

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumenta të mjaftueshme në tregtimin/shpërndarjen e energjisë brenda 7 viteve të fundit, në të cilën të shprehet dhe fuqia në MW.

Ofertuesi i cili ofron fuqinë më të lartë të ndërtuar të impjanteve për prodhimin e energjisë me gaz brenda 7 viteve të fundit, do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Koha për rikonstrukcionin e TEC (shprehur në muaj)***

Koha për rikonstrukcionin e TEC nënkupton periudhën nga marrja e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për fillimin e punimeve deri në përfundimin e tyre dhe vënien në punë të TEC-it.

Ofertuesi i cili ofron kohën (në muaj) më të shkurtër për rikonstrukcionin e TEC-it do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

- ***Koha për ndërtimin e tubacionit të gazit (shprehur në muaj)***

Koha për ndërtimin e tubacionit të gazit nënkupton periudhën nga marrja e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për fillimin e punimeve deri në përfundimin e tyre dhe vënien në funksion të tubacionit të gazit.

Ofertuesi i cili ofron kohën (në muaj) më të shkurtër për ndërtimin e tubacionit të gazit do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

Shtojca 12: VETË-DEKLARIMI PËR OFERTUES TË HUAJ

